



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 1042/2 Prot.

Tiranë, më 14.02. 2022

Të dhëna mbi Vendimin

Nr. 15, datë 14.02.2022

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje nenit 78/1/a të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Biba-X" shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim, për qëllime kualifikimi, në procedurën e prokurimit me objekt: *Rikonstruksion i disa akteve rrugore të Bashkisë Vlorë faza II*, të zhvilluar nga Bashkia Vlorë në datë 09.04.2021 me fond limit 11.771.439 lekë pa Tvsh.

APP i ushtron detyrat dhe kompetencat e saj në bazë dhe për zbatim të nenit 23, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP").

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit NIPT, adresa): "Biba-X" Shpk, me NIPT K32618815N, me adresë: Fshati "Kryeluzaj", pika inerte 50 m pranë Karburantit "Eurodrin", Kavajë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "BIBA-X" shpk, ka nisur nga raportimet periodike të informacioneve dy palëshe ndërmjet APP dhe Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në vijim "ISHPSHSH"), ku ka rezultuar se, ky subjekt në datën e zhvillimit të procedurës të mësipërme të prokurimit, rezulton të ketë patur në fuqi masën administrative gjobë, sipas shkresës së dërguar nga ISHPSHSH.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP.

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 15 datë 14. 02.2022, APP ka vendosur të përjashtojë 14 (katërmëdhjetë) muaj operatorin ekonomik "BIBA-X" shpk me NIPT K32618815N, nga e drejta për të fituar kontrata publike.